



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
NOTER Tomorr R. HAXHIAJ

Nr 948 Rep  
Nr 255 Kol

TAKSA E PËLQËSIAVE  
U TAGUA



### DËSHMI TRASHËGIMIE LIGJORE

Sot, më datën 05 Korrik 2014 (Pesë Korrik Dymijë e Katërmbëdhjetë), unë, Tomorr R. HAXHIAJ, Noter i Dhomës së Noterëve Tiranë, me zyrë noteriale në rrugën "Gjergj Fishta", prapa ish Ekspozitës, pas paraqitjes së kërkesës, dokumentacionit dhe të dhënave të parashikuara nga ligji, hartoj dhe lëshoj këtë dëshmi trashëgimie, mbështetur sa më poshtë :

**Kerkuesia:** Zonja **Arjana SANTO**, e bija e Asllanit dhe e Esmas, e datëlindjes 25.01.1962, e lindur dhe banuese në Rr " Abdi KAZANI" Tiranë, Njësia bashkiake nr. 2, Tiranë, gjinia Femër, gjendja civile e ve, shtetas shqiptar, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 024429547, me nr. personal G25125201F, e cila me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë, parashitroi kërkesën me:

**Objekt :** Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për bashkëshortin e saj të ndjerin, **Artan SANTO**, i biri i Vasilit dhe i Kristinës, shtetas shqiptar i lindur në Tiranë më 07.09.1956, i cili në bazë të certifikatës të vdekjes, lëshuar, në datën 02.07.2014, nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, rezulton se ka vdekur në Tiranë, më 26.06.2014.

**Baza Ligjore:** Dispozitat e Ligjit nr. Nr. 7829 datë 01.06.1994 "Për Noterinë" i ndryshuar dhe në mënyre te specifike nenet 53 dhe 53/1 të këtij ligji. Pjesa III e Kodin Civil, të ndryshuar , në Titullin I e III dhe Neni 348 i këtij Kodi, si dhe në kërkesën, dokumentacionin dhe të dhënat si më poshtë.

Mbështetur në veprimet, kërkesën, dokumentacionin e paraqitur, të dhënat e kërkuara nga ligji dhe dispozitat ligjore në fuqi,

### VËREJ SE:

Kërkesia **Arjana Asllan SANTO**, ka paraqitur në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, në këtë zyrë noteriale ku unë noteri Tomorr R. HAXHIAJ ushtroj veprimtarinë, kërkesën me shkrim, në datën 03.07.2014, me të cilën kërkon, Lëshimin e dëshmisë së Trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin, bashkëshortin e saj të ndjerin, **Artan Vasil SANTO**.

Bashkë me këtë kërkesë dhe në vijim të procedurave, me kërkesën time, nga kërkesia u paraqit edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Çertifikatë Vdekje, datë 02.07.2014, lëshuar për trashëgimlënësin **Artan Vasil SANTO**, nga zyra e gjendjes civile Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, ku se



në bazë të aktit të vdekjes Nr 194, datë 02.07.2014, rezulton se ka vdekur *Artan Vasil SANTO* më 26.06.2014.

Me aktin e gjendjes familjare deri më, datë 02.06.2012, lëshuar më datën 02.07.2014, për trashëgimlënësin *Artan Vasil SANTO*, nga zyra e Gjendjes Civile Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

- Çertifikatë Martesore, datë 02.07.2014, lëshuar për *Arjana Asllan SANTO*, dhe të ndjerin *Artan Vasil SANTO* nga zyra e gjendjes civile Njësia Bashkiake nr.2, Tiranë, në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile ku rezulton se kanë lidhur martesë më 05.09.1983.
- Çertifikatë Personale, datë 02.07.2014, lëshuar për *Arjana Asllan SANTO*, nga zyra e gjendjes civile Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010.
- Çertifikatë personale, datë 02.07.2014, lëshuar për *Emi Artan SANTO*, nga zyra e gjendjes civile Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010.
- Çertifikatë personale, datë 02.07.2014, lëshuar për *Egi Artan SANTO*, nga zyra e gjendjes civile Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur dhe informacionit të dhënë nga kërkuesia lidhur me pasuritë, vedbanimin e fundit, marrëdhëniet e trashëgimlënësit me të afërmit e tjerë dhe gjendjen familjare të tyre,

#### **KONSTATOVA SE:**

Bazuar në nenet 53, 53/1 të Ligjit nr. Nr. 7829 datë 01.06.1994 "Për Noterinë" i ndryshuar dhe në nenin 348 të Kodit Civil, të ndryshuar, kërkuesi legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë, pasi është trashëgimtar ligjor i radhës së parë i të ndjerit dhe unë noteri, kam kompetencën lëndore e tokësore të parashikuar nga ligji dhe duhet të vijoja procedurën e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë, duke kërkuar informacion nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, nëse trashëgimlënësi ka lënë testament dhe /ose është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore apo testamentare për këtë trashëgimlënës.

Dhoma Kombëtare e Noterisë, kërkesës time të datës 03.07.2014, Dhoma Kombëtare e Noterisë i ktheu përgjigje në datën 04.07.2014, duke më informuar se nga verifikimi i Regjistrit Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrit Kombëtar i Dëshmime të Trashëgimisë, nuk rezulton se e ndjeri *Artan Vasil SANTO*, të ketë lënë testament.

Mbështetur në të dhënat e përgjigjes së Dhomës Kombëtare të Noterisë të datën 05.07.2014, si dhe në parashikimet e nenit 348 K. Civil, të ndryshuar, unë noteri kam kompetencën vendore e ligjore për vazhdimin e procedurës për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

Sipas Çertifikatës së Vdekjes, lëshuar më datën 02.07.2014, për trashëgimlënësin *Artan Vasil SANTO*, nga zyra e gjendjes civile Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, ku se

në bazë të aktit të vdekjes Nr 194, datë 02.07.2014 rezulton se ka vdekur në Tiranë, më 26.06.2014.

Pas kësaj date bazuar në certifikatën e gjendjes familjare, Martesore dhe ato personale të paraqitur nga kërkuesia *Arjana Asllan SANTO*, rezulton se trashëgimlënësi i ndjeri *Artan Vasil SANTO*, ka qenë i martuar me zonjën *Arjana Asllan SANTO*, që vërtetohet nga Certifikatës Martesore, lëshuar më 02.07.2014 nga zyra e gjendjes civile Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, sipas Regjistrit Kombëtar të të Gjendjes Civile, ku thuhet se më datën 05.09.1983 kanë lidhur martesë dhe nga martesë kanë lindur dy fëmijë:

1. Vajza **Emi SANTO**, e bija e Artanit dhe i Arjanës, e datëlindjes 23.11.1985, e lindur dhe banues në Tirane, gjinia Femër, gjendja civile e martuar, shtetase shqiptare, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal I56123041S.
2. Djali **Egi SANTO**, i biri i Artanit dhe i Arjanës, i datëlindjes 04.06.1988 i lindur dhe banues në Tirane, gjinia Mashkullore, gjendja civile Beqar, shtetas shqiptare, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I80604062U

Të cilët në bazë të Certifikatave personale, datë 02.07.2014, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile e Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, rezultojnë se janë gjallë.

Sipas dokumentacionit të administruar nuk rezulton se trashëgimlënësi të ketë patur fëmijë jashtë martesë, apo të birësuar.

Gjithashtu nga dokumentacioni i administruar dhe informacioni i dhënë nga kërkuesia, nuk rezulton që trashëgimtarët e tij, të kenë hequr dorë nga trashëgimia, apo të jenë shpallur të padenjë.

- Në referim te nenit 361 të Kodit Civil, *në radhë të parë në trashëgim thirren fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta.*

Mbështetur në nenin 361 të Kodit Civil, për trashëgimlënësin *Artan Vasil SANTO* do të thirren si trashëgimtarë të radhës së parë bashkëshortja dhe dy fëmijët e tij, të cilët do të trashëgojnë në pjesë të barabarta pasurinë e trashëgimlënësit.

Meqenëse janë tre trashëgimtare ligjore të radhës së parë, të trashëgimlënësit *Artan Vasil SANTO*, pasuria trashëgimore u takon në pjesë të barabarta nga 1/3 secilit, për gjithë pasurinë e luajtshme e të Paluajtshme, si dhe depozitat bankare dhe po në të njëjtat raporte përgjigjen dhe për detyrimet që rëndojnë mbi këtë trashëgimlënës.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 348, Kodit Civil e neneve 306-310 të K. Pr. Civile dhe të nenit 53, 53/1 të Ligjit nr. 7698, dt. 01. 06. 1994 "Për noterinë", që përcaktojnë kompetencën e noterit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, unë noteri, lëshoj dëshminë e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin *Artan Vasil SANTO*, me të dhëna e pjesë takuese, si më poshtë:

Në bazë të ligjit të Lirë Trashëgimtarë të radhës së parë për trashëgimlënësin Artan Vasil SANTO,

- Arjana Aslan SANTO - Bashkëshortia
- Emi Artan SANTO - e bija
- Egi Artan SANTO - i biri

të cilët do të trashëgojnë në pjesë të barabarta nga 1/3 secili të gjithë pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit Artan Vasil SANTO, të luajtshme e të paluajtshme dhe depozitat bankare dhe po në të njëjtat raporte përgjigjen dhe për detyrimet që rëndojnë mbi këtë trashëgimlënës.


Të drejtat trashëgimore dhe detyrimet e lidhura me këtë trashëgim u kalojnë të sipërcituarve në pjesë të barabarta nga 1/3 secilit.

Kjo dëshmi trashëgimie u lëshua sot më 05.07.2014 në Tiranë, që është vendi i çeljes së trashëgimisë.

**NOTER**

*Tomon 2 Hoxhë*

*Official*  
*Noter*





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 8045 Rep

Tirane, me 21.07.2014



VERTETIM  
NJESIA ME ORIGINALIN

Unë, Noter Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterisë Tirane, me seli në Rr. "Pjeter Bogdani" Nr. 13, Tirane, vërtetoj se **njësia bashkëlidhur është kopje e njëjtte me dokumentin original.**

Dokumenti është Dëshmi trashëgimie ligjore me nr. 948 rep nr. 255 kol date 05.07.2014.

Dokumenti u paraqit nga Znj. Alketa Mustaka, e njohur prej meje noterit.

Vërtetimi i dokumentit u bë në bazë të nenit 56, të ligjit nr. 7859, date 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar) dhe pikave 3,4,7 të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr. 6291, date 17.08.2005.

NOTER  
JULIAN ZHELEGU

